ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL - OBILIQ**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **OB614-24-1325-5-2-1**

Sa i përket tenderit për **Sinjalizim horozital dhe vertikal**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**N.SH. " Liriu "**
NUI	**600893136**
Adresa	**Brig.123**
Vendi	**SUHAREKË**
Kodi postar	**23000**
Numri Telefonit	**049-502-555**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Selman Kolgeci**
Adresa elektronike	**nsh.liriu@gmail.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**03.05.2024**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Sinjalizim horozital dhe vertikal

1. **Shpallja e njoftimit per kontrate eshte bere me date : 26.02.2024 ,**
2. **Sqarime i dosjes tenderit Sinjalizimi horizontal dhe vertical 29.02.2024**
3. **Sqarime Shtes-TSR SHPK 07/03/2024**
4. **Sqarime Shtes 11.03.2024**
5. **Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara 29.02.2024**
6. **Procesverbali i hapjes se Tenderve 20.03.2024**
7. **Njoftim mbi Vendimin e AK-Së ANULIM 11.04.2024**
8. **Kërkesa per rishqyrtim 16/04/2024**
9. **Vendimi I AK ë Refuzim I Kerkeses per Rishqyrtim**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ ***Jo*** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Kërkesa per rishqyrtim 16/04/2024

Vendimi I AK – Refuzim I Kerkeses per Rishqyrtim

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 Qëllimi

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 62 Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

AK me datë: 11.04.2024 ka publikuar njoftim vendimin per anulim të aktivitetit të prokurimit. Në arsyen e anulimit thuhet se një gabim ka ndodhur dhe i nëjti është i parevidueshëm. Por kjo nuk qëndron sepse asnjë gabim nuk ka ndodhur në të paktën ofertën që ne kemi dorëzuar e sigurishtë edhe OE tjerë kanë vepruar siq

kemi vepruar ne duke vendosur çmimet që janë kërkuar krahas sasisë për secilin pozicion.

Në këtë procedurë të prokurimit ne jemi OE i përgjegjshëm dhe kemi ofertuar me çmimin më të lirë.

Pretendimi 1. AK anulimin e procedurës e ka bërë në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së, sepse konform këtij neni përfundimi i aktivitetit të prokurimit duhet të bëhet vetëm

për njërën nga arsyet si më poshtë:

Neni 62

Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:

2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo

2.2. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.

Në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me asnjërën nga arësyet që parasheh neni 62 i LPP-së.

Për këtë procedurë AK ka përdorur përshkrimin e çmimeve formën JO STANDARDE dhe ne si OE kemi vendosur çmimet për secilin pozicion. Bazuar në njësinë e

secilit pozicion dhe çmimin e ofruar nga ne, kemi llogaritur shumën dhe totalin për

komplet ofertën. Pra oferta jonë nuk përmban asnjë gabim aritmetik siq pretendon AK.

AK pretendon që anulimi është bërë sepse disa nga OE nuk kanë përfshirë në total të ofertës disa pozicione. Kjo është qështje e secilit OE individualishtë që të kontrollojë formularin e tenderit pjesë e të cilit është edhe përshkrimi i çmimeve forma JO STANDARDE.

Për më tepër, nëse disa nga OE nuk i kanë përfshirë në total të gjitha pozicionet, del që këta OE dalin me oferta edhe më të larta se sa janë në procesverbal të hapjes, qka nuk e ndryshon rezultatin e ofertës sonë e cila është oferta më e lirë.

Këtë qështje specifikisht e ka sqaruar OSHP në vendimin e datës: 07.06.2023 (vendimi i OSHP-së nr.49/23 bashkangjitur kësaj kërkese për rishqyrtim), ku një AK kishte anuluar një aktivitet të prokurimit me të njëjtën arësye dhe OSHP e ka detyruar AK që të kthejë lëndën në RIVLERËSIM dhe ka aprovuar ankesën e OE ankues i cili sikurse ne në këtë rast nuk ka asnjë gabim në përshkrim të çmimeve dhe OSHP me të drejtë ja ka aprovuar ankesën.

Ky është konstatimi i OSHP-së për rastin identik që ka pas një AK tjeter lidhur me anulimin e procedurës me të njëtën arsye që AK e ka anuluar dhe qe mendojme qe kete e ka bere në kundërshtim më nenin 62 të LPP-së:

Citim i Vendimit 49/23 :

Paneli shqyrtues, pas shgyrtimti dhe analizimit te te gjitha provave, fakteve dhe dokumentacionit te prezantuar per kete procedure te prokurimit, ne ankese dhe shkresat e te gitihe aktivitetit te prokurimti ne sistemin e e-prokurimit, kontstaon se anulimi i ketij aktiviteti te prokurimit eshte bëre ne kundershtim me nenin 62 te LPP-se, duke u bere aplikimi i gabuar i kesaj dispozite dhe ligjit material.

Paneli shqyrtues sqaron se anulimi i ketij aktiviteti te prokurimit eshte bere me

arsyetimin se ka ndodhur nje gabim i pariparueshem tek lista e pershkrimit -paramases dhe parallogarise, pjesa C e dosjes së tenderit.

Paneli shqyrtues analizoj dosjen e tenderit, me saktesisht pjesen C per te cilen AK ka anuluar këtë aktivitet te prokurimit me arsyetimin se ka gabime ge nuk jane te evitueshme dhe konstaton se kjo pjese i permban te gjitha informatat relevante, te pershkruara ne menyre te garte dhe te sakte te lidhura me lenden e kontrates ne fjale, duke ju mundësuar OE te interesuar per te pasur njohuri të sakta per pergaditjen e tenderëve pa kerkuar informata shtese.

Bashkangjitur gjeni edhe Vendimin e OSHP-së

Meqenëse një qeshtje e tillë tani më është gjykuar nga OSHP-ja, si dhe duke u bazuar në të gjitha faktet dhe deshmitë që u ceken më lartë, shpresojmë se OSHP do të nxjerr:

VENDIM

APROVOHET ANKESA e Operatorit Ekonomik N.SH. " Liriu "
ANULOHET Njoftimi mbi vendimin e AK-së (Vendimi i anulimit të procedures se Prokurimit) dhe lenda të kthehet në Rivlerësim. Meqenese kompania jone eshte e pergjegjshme dhe ka ofertuar me qmimin me te lire e njejta te shperblehet me kontratë.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

-Te gjitha pikat që janë cekur në Dekleratën tonë, janë shkelje të cilat na kanë dëmtuar ne si OE e të cilat na krijojnë kosto si në përgaditje po ashtu në konkurencën jo të drejtë dhe na bëjne që të kërkojme nga ju të aprovoni si te bazuar

ankesen tone në mënyrë që edhe ne si OE të jemi të barabartë në këtë procedurë të prokurimit dhe të jemi fitues të ketij projekti si OE i përgjegjshëm me çmimin më të lirë.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*